



NËN RADAR

*Kujtimet e Luftës
së Dytë Botërore në Kosovë*

Para shtatëdhjetë viteve, përfundoi Lufta e Dytë Botërore dhe filloi beteja për ta kontrolluar kujtesën e kësaj lufte. Në Kosovë, kujtime të ndryshme paraqiten si kujtimet e vetme të vërteta të luftës: ekziston një kujtesë e rezistencës anti-fashiste, një kujtesë e vrasjeve etnike të partizanëve, njëjtë sikur që ekzistojnë edhe tregimet mitike të jetës ndër okupimin italian dhe gjerman ja si idilike, ja si tragjike. Secila prej tyre, në kohëra të ndryshme u bë kujtesë zyrtare, duke i lënë kështu kujtimet tjera nën radar.

Me këtë ekspozitë ne duam të sfidojmë idenë së ekziston vetëm një e vërtetë e historisë së Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, apo se vetëm një grup – qofshin shqiptarët apo serbët, nacionalistët apo socialistët – e posedon këtë të vërtetë. Nuk ka të vërteta në kujtime homogjene që bazohen në një nocion abstrakt të popullit. Kujtimet homogjene janë të pavërteta sepse nuk janë kritike dhe i mohojnë të vërtetat e pakëndshme, si për shembull krimet e luftës që bëhen nga populli respektiv. Por ato janë veçanërisht të pavërteta sepse nuk e njohin shumëllojshmërinë që ekziston brenda cilitdo grup.

Këtë na e lejon historia gojore: të thejmë monopolin e së vërtetës - pa marrë parasysh a e ka këtë monopol shteti, kombi, apo një grup politik - në mënyrë që t'i dëgjojmë rrëfimet që ekzistojnë nën radar. Këtu ju prezantojmë rrëfime të shkurtra për individë që qëlluan të jenë protagonistë në ngjarje të mëdha. Ata identifikoheshin me grupe më të mëdha se vetja, por bënë zgjedhje individuale kur ishte gati e pamundur për të zgjedhur lirshëm, në një kohë kur lëvizje më të mëdha të popujve dhe ideve rrëmbyen Kosovën. Ndonjëherë ata e gjetën veten të tërhequr në anë të kundërta prej besnikërive të ndryshme që kishin ndaj ideve apo vendeve. Duke i ritreguar rrëfimet e tyre, ata apo familjet e tyre, na tregojnë se çka u është imponuar, dhe si t'i interpretojmë edhe rrëfimet e tyre por edhe vet Historinë.



Vahide Hoxha në Konferencën e Krahinore të Lëvizjes Rinore Anti-Fashiste.
Gjakovë, 18 nëntor 1944.

Vahide Hoxha (1926-2013) punoi si edukatore gjatë tërë jetës, ishte reformuese dhe aktiviste. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Vahidja u bë aktive në lëvizjen e të rinjëve anti-fashistë ku edhe takoi të shoqin komandantin partizan dhe udhëheqësin e Kosovës së pas luftës, Fadil Hoxhën. Para vdekjes ishte kryetare e Shoqatës së Veteranëve së Luftës Nacionale Anti-fashiste të Kosovës.

“Konferenca filloi, fillun përshëndetjet. [...] Në sallë hyni komandanti, thanë, “Po vjen komandanti!” U çumë të gjithë në kamë e shuplakat [...] unë komandantin s’e kam pa. E kam ditë se asht komandant Fadil Hoxha, po kush asht’ nuk e kam ditë. Mas përshëndetjes përsëri vazhdoi rrugën ashtu si ushtar edhe shkoi. Por, organizatorët [...]na lajmrinë që do t’mahet një ballo në mramje për me argëtu ata delegatët [...]. Edhe une shkova, u ula me një shoqe temen asht prej Prizrenit. Kur filloi muzika erdh komandanti, u afru edhe asaj shoqes teme po i thotë, “A po lejon qi ta marrë une këtë shoqen tande për me kcy?” [...] qysh mbrijti ai me ardhë te une [...] se unë e përshëndeta n’konferencë, hypa atje naltë. I tregova si ka punu rinia antifashiste e femnave në Prizren edhe urova konferencën e qaq. Qaq ishte!”

Një fragment i marrë nga intervista e Antigona Qena Kaçaniqit, emetuar në emisionin Pa Skenar.



Sadik Stavileci, hero i kombit.

Sadik Stavileci (1915-1942) u vra në Tiranë nga trupat italiane së bashku më Vojo Kushi dhe Xhorxhi Martin, të gjithë anëtarë të rezistencës komuniste. Pas luftës, vetëm Vojo Kushi u komemorua si hero kombëtar. Shkëlzen Maliqi, nipi i Sadikut, e tregon se si Stavilecët krijuan një tregim apokrif për t'i dhënë kuptim mosnjohjes së heroizmit të Sadikut.

“Sipas kësaj legjende [...] nuk ka qenë Vojo Kushi trimi që ka kërcyer mbi tanksin e armikut, por ka qenë pikërisht Sadiku, por ja që të vërtetë e kishin shtrembëruar qëllimshëm Enver Hoxha dhe Partia e Punës për arsye se daja im, si njëri prej udhëheqësve të grupit të komunistëve të rinj, në kohën kur po bëheshin përpjekjet e bashkimit të grupeve të ndryshme dhe formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, paskësh qenë kundër zgjedhjes së Enver Hoxhës në krye të partisë. Arsyeja tjetër për retushimin e ngjarjes, gjithnjë sipas versionit që e kam dëgjuar nga daja Tasim dhe gjyshja Zyhra, ka qenë prejardhja kosovare e Sadikut. ‘Në Shqipëri ka paragjykime ndaj kosovarëve. Ata s’na duan... Bile edhe komunistët, edhe pse shiten si internacionalistë, janë me paragjykime ndaj kosovarëve, i konsiderojnë malokë e të pagdhendur’. Unë vetë nuk i kam besuar verbërisht këtij versioni apokrif që Sadikun e tregonte si kryeherin e njëres prej ngjarjeve më të rëndësishme nga historia e rezistencës antifashiste në Tiranë. Vdekja e tij së bashku me dy shokët gjithsesi ka qenë heroike, s’ka rëndësi se cili ka kërcyer mbi tank! [...]Në familjen tonë thjesht mbahej në mend kjo që Sadiku është deklaruar kundër Enver Hoxhës. Dhe unë që nga fëmijëria e kisha këtë si një argument më shumë për të qenë anti-enverist. Isha i bindur se daja Sadik e ka nuhatur mirë karakterin e Enver Hoxhës.”

Fragment i marrë nga libri i Baton Haxhiut “Shkëlzen Maliqi - Shembja e Jugosllavisë, Kosova dhe rrëfime të tjera”. Prishtinë: Filozofia Urbane, 2013.



Qërim Vasolli (1912-?)

Rrëfimi i Qërim Vasollit, siç e tregon nipi i tij Përparim Vasolli.

“Qërimi lindi në vitin 1912 në Orllan, ku tani është Liqeni i Batllavës, përveç se atëhere nuk ka pas liqe, vetëm tokë të pllëshme që Vasollët e kanë punuar. Me 1941, në atë pjesë erdhën çetnikët dhe vranë pesë vëllezërit e Qërimit. Vetëm ai dhe një vëlla i vogël i shpëtuan masakrës dhe erdhën në Prishtinë. [...] Nuk kemi asgjë prej Qërimit përveç fotografisë me madhësi të letërnjoftimit që e mbaj në iPhone. [...] Gjatë një kohe, pas masakrës së vëllezërve, Qërimi vizitoi familjen e tij në Prishtinë por vetëm gjatë natës. Ai asnjëherë nuk flejti në shtëpi. A po fshihej në male? Nga kush? A ishte duke luftuar? [...] E dinim që ishte arrestuar gjatë viteve 1946-47 dhe ishte dërguar në burgun e Pozharevacit, nga i cili u arratis[...] Qërimi u pa në vitin 1948 nga dikush i Prishtinës që ishte ushtar i Titos i pozicionuar në kufi të Italisë.”



Sylejman Beg Kryeziu me oficerë italianë, Gjakovë,
Dita e Flamurit, 1941 apo 1942.





Sylejman Beg Kryeziu me oficerë italianë, Gjakovë,
Dita e Flamurit, 1941 apo 1942.

Rrëfimi i Sylejman Beg Kryezit, siç e tregon mbesa e tij Shqipe Malushi.

“Sylejman Beg Kryeziu, ishte kryetar i Gjakovës dhe deputet në Parlamentin e Mbretërisë jugosllave nga viti 1925 deri me 1941. [...] nga viti 1941 deri me 1943, ishte vetëm kryetar i Gjakovës [...] Edhe pse fashistet italianë kishin okupuar Gjakovën, në atë kohe ishte gati në mode që udhëheqësit e rankut të lartë të ishin bashkëpuntorë me okupuesit. Gjyshi im nuk ishte agjent i askujt [...] gjyshi im vishej me tesha kombëtare, vetëm pse dëshironte të theksonte identitetin e tij kombëtar gjersa ishte duke i shqyrtuar urdhërat e okupuesve për ta mbrojtur popullin e vet.

Me 1944, pasi që italianët e lëshuan Gjakovën. [...] një ditë agjentët nacistë, në krye me Xhafer Devën, u kthyen në shtëpinë e gjyshit tim dhe e pyetën atë, ‘Na trego se cilët janë komunistët në qytetin tënd? Na i jep emrat e tyre?’ ‘Ne nuk kemi komunistë në qytetin tonë,’ ishte përgjegjja e gjyshit. [...] ‘Si mund t’ua jap emrat e tyre kur gati e gjithë rinia është kundër okupimit, ata as nuk e dijnë domethënjen e komunizmit, t’i dorëzoj ata do të thote t’i dorëzoj fëmijët e mi’, ishte përgjegjuri ai [...]

Pak para se të vinte në fuqi pushteti i ri komunist, dikush u kishte thënë gjermanëve se gjyshi i kishte mbrojtur komunistët. Ata kishin ardhur dy ditë pas kërkimit të tyre të pa sukseshëm të makinës së shkrimit dhe e kishin marrë me vete pa asnjë shpjegim. Pastaj e kishin dërguar në kampin gjerman në Austri. Pas luftës, kur erdhi pushteti i ri komunist i Jugosllavisë, e deklaruan gjyshin tim si kriminel lufte. Ai nuk do të guxonte të kthehej në Kosovë për shkak se do të ekzekutohej sikurse u ekzekutuan dy djemtë e tij. Ne fillim shkoi në Itali, por atje nuk gjet rehati. Pastaj shkoi në Izmir të Turqisë [...] pa e pa kurrë me familjen e vet.”



Emrush Myftari si vullnetar në forcat republikane në Luftën Civile të Spanjës, 1938.


Emrush Myftari (1909- 1944) u lind në Pejë, studio në Liceun francez të Korçës, dhe kreu akademinë mbretnore ushtarake në Tiranë. U vra në vitin 1944 në Prishtinë nga shërbimi sekret jugosllav OZNA, ndër dyshimin se ishte nacionalist dhe shpiun i britanikëve.

“Babain tim në vitin ... dikun kah fundi i vitit ‘44, ose n’fillim të vitit ‘45 e kanë ekzekutu’ e kanë pushkatu’ ... Unë kam qenë dikun një vjet e diçka kur ka vdekë babai...

N’vitin 1937 shpërthen lufta në Spanjë. Atëhere baba im, Veli Dedi, Xhemajl Kada, Shaban Basha shkojnë si vullnetarë në luftën e Spanjës ... Kta kanë qenë të organizum në Batalionin Garibaldi i cili ka pasë si sekretar ose si udhëheqës të atij Batalioni Luigji Long-un.. aty kanë qenë edhe shkrimtarët e njoftun si Orvelli, mandej ka qenë Hemingvej ... Babai im ka qenë domethonë me ide të majta...

Kur ka kapitulu domethonë Lufta e Spanjës ata kanë kalu’ në Francë ... Zogu nuk i pranon me u kthy në Shipni meqë kanë qenë me ide komuniste, atëhere baba shkon në Turqi, shkon në Palestinë, shkon në kto shtetet e Lindjes domethonë ... Prej Turqisë kthehet mandena edhe natyrisht se kyqet në Lëvizjen Komuniste ktu në Pejë... edhe e hapë librarinë e parë në Pejë. Libraria quhej Libraria Skënderbej – Vllazën Myftari...

Preteksti për pushkatim ka qenë se ka qenë anëtar i Intelligence Service-it, mbasi e ka ditë gjuhën angleze plus e kishte pasë edhe një mike angleze, njëfar Flavia Kingston. Domethonë edhe e konfiskojnë pasuninë e babës.”



Bedri Pejani me familjen e tij në Pejë. Data e panjohur.

Bedri Pejani (1885-1946) u lind si Bedri Thaçi, por morri emrin e vendlindjes siç ishte zakon në atë kohë. Ishte anëtar i lëvizjes kombëtare shqiptare gjatë sundimit osman. Ai ishte i pranishëm në nënshkrimin e Deklaratës së Pavarësisë Shqiptare në vitin 1912. Ai përfaqësoi Kosovën në Konferencën e Versajës në 1919. Bedri Pejani ishte njëri ndër themeluesit e Komitetit të Kosovës dhe udhëhoqi Partinë e Popullit, të themeluar nga Fan Noli.

Derisa ishte në ekzil pasi që u dënua me vdekje nga Ahmet Zogu në vitin 1924, ai u bë udhëheqës i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, me përkrahjen politike dhe financiare të Ndërkombëtares Komuniste (Komintern). Nën okupimin fashist italian të Shqipërisë ai u arrestua si bolshevik dhe u mbajtur deri në kapitullimin e Italisë më 1943. Kur gjermanët erdhën në fuqi, Pejani nisi Lidhjen e Dytë të Prizrenit e Xhafer Devën dhe përkrahjen e okupatorëve. Lidhja e Dytë e Prizrenit ishte përgjegjëse për një valë të përzënive të dhunshme të kolonëve serbë dhe malazezë, të cilëve u ishtë falur tokë pas Luftës së Parë Botërore. Pejani u arrestua në 1946ën nga partizanët. Pas një kohe të shkurtë, supozohet se është helmuar në spital, ku edhe është mbajtur për arsye shëndetësore.



Abdullah Zajmi me klasën e tij. 1943-44, Novi Pazar.

Abdullah Zajmi (1922-2001) ishte mësues, përkthyes dhe autor librash shkollor. Më poshtë, një fragment nga autobiografia e tij.

“Ministria e Arsimit e Shqipërisë, [...] me 27.X. 1942 më emëron mësues në Suhi Doll të Peshterit. Unë, as që e dija se ku ndodhej Suhi Doll, por, për fat, në Kursin pedagogjik kisha një shok të ngushtë nga Rozhaja, të cilin e quanim ‘Boshnaku’ Shuqo. Me të shkuam në Pejë e të nesërmen u nisëm në këmbë për Rozhaje. Në mbrëmje arritëm në shtëpinë e tij. Pas dy ditësh, me një shoqërues shkova në këmbë në Tutin te Shemsedin Hadri, i cili ishte sekretar i nënprefekturës, ndërsa kryetar ishte Nexhat Begolli. Pas disa ditësh erdhi njëri nga Komuna e Suhi Dollit dhe me kuaj shkuam në Suhi Doll. Është e pamundur të përshkruhet përshtypja që më bëri takimi me vendasit. Të gjithë ishin shqiptarë.

Më çuan në objektin që shërbente si shkollë [...] Më pritnin nxënësit (nja 20-30) mashkuj, të veshur me rrobe kombëtare [...] Shqipën e flisnin mirë. Pas pak erdhi sekretari i Komunës, i vetmi nëpunës i komunës. Edhe ai, si shumica e mashkujve të rritur, e kishte pushkën në krah. Në atë trevë zhvilloheshin shpesh lufta të përgjakshme në mes të partizanëve e çetnikëve, në mes të partizanëve e ushtrisë okupuese italiane, në mes të shqiptarëve (boshnakëve-muslimanëve) e çetnikëve, prandaj të gjithë ishin të armatosur e të gatshëm për tu mbrojtur.”



Ekspozitë
“NËN RADAR
Kujtimet e Luftës së Dytë Botërore në Kosovë”
Iniciativa Kosovare për Histori Gojore
Maj 2015
Prishtinë, Kosovë.

Fabrizio La Rocca (Dizajni)
Anna Di Lellio (Teksti)
Lura Limani (Produksioni)

Falenderime të veçanta u shkojnë të gjithë atyre që ndanë
me ne arkivat e tyre personale dhe familjare.